



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____. _____. 2025

Për kritere e marrjes me qera nje ambjent per kopështin Nr.10

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.139/2012 “Per sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr.15 datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitar”, i ndryshuar, dhe sipas projektit egzistues të kopshtit Nr.10, mjediset me qera duhet të plotësojnë këto kritere:

1-Vendndodhja duhet të jetë Rajoni Nr.3, blloku midis rrugës “Hasan Kushta” dhe rrugës “Lef Sallata”.

2-Certifikatë pronësie, kartelë+hartë, e rifreskuar(E konfirmuar 3 muajt e fundit në ASHK Vlorë).

3-Objekti duhet të jetë 1-2-3 katësh për arsye sigurie sipas VKM ne fuqi. Të jetë të paktën 680m² , sa sipërfaqe ndërtimore totale e objektit egzistues Kopshtit nr.10. Objekti duhet të jetë në gjendje të mirë , pa lagështi, në standarde për shfytëzim.

4-Normë shfrytëzimi 1.3-1.6m², dmth, klasa mësimore 32.5m²-40m² ose 53.75m² sikurse janë klasat egzistuese të Kopshtit Nr.10.

Gjithsej 8 mjedise për klasa mësimore/mjedise fjetje sepse kopshti ka :

Grupe I - 2

Grupe II -2

Grupe III - 3

Grup i përzierë - 1

Një mjedis/zyrë drejtorie.

Një mjedis për kuzhinë gatimi, të paktën sa mjedisi egzistues i gatimit 25m². Të ketë KUZ , KUB funksionale, në standarde.

5-Bokse 3 copë/grup dhe 4 lavamanë/grup
Shërbime higjienike edhe për personelin.

6-Kënd sportiv jo më të vogël se 100m²/oborr

7-Norma e ndriçimit 15%, xhama të tejdukshëm

8-Sistem të mbrojtjes ndaj zjarrit (Për më shumë se 200 fëmijë duhet shkallë emergjence)

9-Depozitë uji

10-Sistemin e furnizimit me energji elektrike 3-fazor

11-Sistem kondicionimi

12-Gjerësia e shkallëve të paktën 2m.

Për çdo tregues tjetër i referohemi VKM nr. 319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”.

Për çdo kriter tjetër të negociohet për të siguruar të paktën standardin e kopshtit egzistues, Kopshtit Nr.10

Vlera minimale e qerave mujore është 204.000(dyqind e katër mijë)lekë në muaj

Llogaritja është bërë në bazë të VKM 469 datë 03.06.2015 “Për Përcaktimin e Vlerave Minimale të Cmimit të Referencave të Qerave të Ndertesave për Qellime Tatimore”.

Data për dorëzimin e dokumentave është 30.06.2025 , Zyra e Informacionit, Bashkia Vlore